



KONFERENCA NDËRKOMBËTARE Ë KONKURRENCËS

“Konkurrenca dhe Rritja Ekonomike”

E martë, 04 Mars 2014, Sheraton Hotel, Tirana, Albania

Fjala e Kryetares së Autoritetit të Konkurrencës Znj. Lindita Milo(Lati)

I nderuar Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes,

I nderuar Z. Rumbold, përfaqësues i Delegacionit të Bashkimit Europian në Tiranë,

I nderuar Z. Bregasi përfaqësues i Biznes Albania,

I nderuar Profesor Kule,

Të nderuar kolegë e pjesëmarrës!

Ndihem e privilegjuar që t’Ju adresohem sot, me rastin e 10 vjetorit të Autoritetit të Konkurrencës, në këtë Konferencë Ndërkombëtare, tematika e së cilës nuk është një zgjedhje e rastit.

Ndikimi i zbatimit të politikës dhe ligjit të konkurrencës në rritjen ekonomike, si një nga temat e debatit ekonomik në Shqipëri, tregon se ky aktivitet nuk është vetëm për të festuar, por për të reflektuar e menduar: çfarë duhet bërë më mirë; cilat instrumenta duhet të përdoren nga të gjithë faktorët dhe aktorët e tregut, për të garantuar rritjen ekonomike.

Historia e vendosjes së ekonomisë së tregut, rruga e zhvillimit të tij dhe shkalla e zbatimit të ligjësive që kërkon një treg funksional, përbën jo vetëm një ditar eksperiencash, por për më tepër një sfidë të vazhdueshme për institucionin e konkurrencës, me një eksperiencë 10 vjeçare.

Vendosja e tregut në kushtet e efikasitetit duke e mbrojtur nga loja antikonkurrese e një apo disa lojtarëve të tregut, apo ndikimi i shtetit si faktor në treg përbën filozofinë e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës

Sot, institucioni i konkurrencës është më i konsoliduar se 5 vjet më parë, fakt i cili është evidentuar qartë nga Komisioni Europian në raportet e progresit se : Autoriteti i Konkurrencës është një nga institucionet që ka rritur performancën dukshëm.

Inkurajimi nëpërmjet vlerësimeve shumë pozitive për performancën në zbatimin e ligjit, rritjen dhe forcimin e kapaciteteve administrative dhe përhapjen e advokatisë e kulturës së konkurrencës, mbështetja e vazhdueshme nëpërmjet financimeve për forcimin e kapaciteteve institucionale ka qënë një nga faktorët kryesorë për procesin e konsolidimit të institucionit të konkurrencës.

“Shqipëria ka ligje të mira, por jo një zbatim të mirë të tyre” është shprehja që dëgjohet shpesh. Dinamika e zhvillimit 10 vjeçar të institucionit të konkurrencës është një rast i cili mundëson të identifikohen kushtet dhe faktorët që e rrëzojnë këtë shprehje.

Në fushën e konkurrencës Shqipëria ka kuadër ligjor shumë të mirë dhe të përafuar gati 100 % me të drejtën europiane të konkurrencës. Por, ka edhe një zbatim të plotë të ligjit në katër kolonat kryesore të tij: marrëveshjet e ndaluara (kartelet), abuzimin me pozitën dominuese, përqëndrimet dhe advokatia.

Ka qënë sfiduese për Komisionin aktual dhe paraardhës të Konkurrencës, të fillojnë raste hetimore në tregje me kontribut të rëndësishëm në produktin e brendshëm bruto si telefonia celulare, industria financiare, sektori i ndërtimit, prokurimet publike etj., dhe të hetojë ndërmarrje të mëdha dhe me suport ligjor nga studiot më të njohura ligjore të vendit e të Europës, nga Londra në Bruksel. Por sot jemi të bindur që PO, ia dolëm, dhe Shqipëria ka kapacitetet e nevojshme për të përballuar sfidat e integritetit europian në fushën e konkurrencës.

Tema e zgjedhur për këtë konferencë nuk është thjesht një shprehje e ditës, por Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se në periudhat e ngadalësimit të rritjes ekonomike, kur bien normat e fitimeve dhe aksesit në financime, është gjerësisht e pranuar nga Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës (ICN) dhe OECD-ja, se rritet mundësia e përfshirjes së firmave në forma antikonkurrese të sjelljes në treg, të shfaqura në formën e karteleve apo abuzimit me pozitën dominuese.

Megjithatë, duhet pasur parasysh edhe konteksti shqiptar e veçoritë që ka vendi ynë në zhvillimin ekonomik-social dhe atë institucional.

Faktorë të till si informaliteti dhe trajtimi jo i barabartë i lojtarëve të tregut, qoftë edhe nga veprimet apo mosveprimet e nënpunësve të shtetit, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbatimin e së drejtës së konkurrencës në Shqipëri.

E drejta e konkurrencës është pjesë përbërëse e institucionit të së drejtës, zbatimin nga të gjithë institucionet publike i së cilës, përbën një nga instrumentat e luftës ndaj korrupsionit.

Një tjetër problem i rëndësishëm, e evidentuar nga eksperiencat disa vjeçare të Autoritetit të Konkurrencës është mungesa e përvojës dhe e njohurive për një vlerësim të plotë të efekteve të një praktike antikonkurrense në treg, nga ana e institucioneve të pushtetit gjyqësor, të cilat shkaktojnë probleme për zbatimin efektiv të së drejtës së konkurrencës.

Vetë komuniteti i biznesit duhet të bashkëpunojë në mënyrë pro-aktive me Autoritetin e Konkurrencës, veçanërisht në drejtim të nxitjes së kulturës së konkurrencës, me anë të aktiviteteve të përbashkëta e politikave individuale të bizneseve, për të siguruar që veprimtaria e tyre të jetë në përputhje me rregullat e konkurrencës.

Qëllimi kryesor i së drejtës së konkurrencës është shpërndarja efiçente e burimeve, mision i cili mundësohet plotësisht vetëm nga një bashkëpunim shumë i ngushtë midis rregullatorëve të tregjeve specifike dhe institucionit të konkurrencës. Një sfidë e vazhdueshme kjo, për të kapërcyer shqetësimet e momentit, me të cilat ballafaqohen këto tregje, për të konverguar në qëllimin për të garantuar mirë funksionimin e qëndrueshëm të tyre.

Pushteti ekzekutiv duhet që të bashkëpunojë ngushtësisht me Autoritetin e Konkurrencës në drejtim të zbatimit të politikës së konkurrencës dhe liberalizimit sa më të plotë të ekonomisë shqiptare.

Ndodh që qeveria të marrë masa të caktuara, të cilat mund të sjellin një kufizim apo përqendrim tregu, siç është dhënia e të drejtave ekskluzive apo të veçanta. Por, është pikërisht bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës, si garanti publik për kushtet specifike të shërbimit apo produktit dhe mundësimin e realizimit të të ardhurave të arësyeshme nga ana e firmës që e përfiton këtë të drejtë, që do të çojë në një proces sa më pro-konkurrense edhe në të tilla raste.

Rritja e qëndrueshme dhe reale ekonomike kërkon që të sigurohet zbatimin rigoroz i ligjit dhe i politikës së konkurrencës, pasi konkurrenca është një motor për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Por, Autoriteti i Konkurrencës është vetëm një nga pjesët e këtij motorri, prandaj, është e domosdoshme, që të gjitha pjesët e tij të punojnë në

mënyrë të koordinuar, që ekonomia shqiptare të jetë sa më efiçente dhe të sigurohet një rritje e qëndrueshme .

Të nderuar pjesëmarrës,

Konkurrenca është një vlerë e tregut dhe e shoqërisë në përgjithësi, prandaj nxitja dhe mbrojtja nga kufizimet e mundshme është një sfidë e vazhdueshme e Autoritetit të Konkurrencës, por jo vetëm.

Pikërisht, përbërja e këtij paneli të nderuar, evidenton faktorët dhe aktorët për një treg sa më funksional, për më tepër diskutimet e ditës së sotme do të hedhin dritë se çfarë duhet bërë më mirë nga ky institucion 10 vjeçar.

Ju falënderoj edhe një herë për pjesëmarrjen dhe vëmendjen tuaj.